5. Vaksinimi i fëmijëve

Disa sëmundje fëminore të rënda janë bërë të rralla dhe madje janë zhdukur në saje të vaksinmit. Një zvogëlim i mbulimit vaksinal do të mund të bënte që ato të rishfaqen dhe të vënë në rrezik fëmijët dhe të rriturit. Vaksinimi është veçanërisht i rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve që mbahen në struktura kolektive si çerdhet, kopshtet e fëmijëve dhe shkollat, etj.

Eshtë me rëndësi që të njihet rregullisht gjendja e vaksinimit të fëmijëve. **Prandaj, libreza e vaksinimit të fëmijës suaj kërkohet në moshën 28 muaj, 7-8 vjeç dhe 14-15 vjeç**. Ky verifikim i librezës së vaksinimit parashikohet në kuadrin ligjor federal dhe kantonal.

Më tepër informacione

Rruga që duhet ndjekur për të transmetuar librezën e vaksinimit

Kur fëmija juaj arrin moshën 28 muaj, 7-8 vjeç dhe 14-15 vjeç, ju merrni një shkresë, që ju fton të transmetoni një kopje të librezës së vaksinimit të fëmijës suaj përmes platformës të sigurtë të Shtetit « e-demarches ».

Për ta bërë një gjë të tillë, ju duhet:

1. Të keni një llogari « e-démarches.ge.ch » (regjistrim i thjeshtë dhe i sigurtë). Nëse nuk e keni një të tillë, ju duhet ta krijoni.
2. Bëni një fotografi ose një skan të të gjitha faqeve (të parme/të prapme) të librezës së vaksinimit.
3. Transmetojini këto dokumente me anën e formularit në linjë.